



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 2.2.2021, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Anastas Angjeli – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i dekretit të Presidentit të Republikës nr. 11 912, datë 11.01.2021, “Për kthimin e ligjit nr. 151/2020 “Për një ndryshim në ligjin nr. 9975”, datë 28.07.2008, “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar”.

Marrin pjesë:

Anastas Angjeli, Senida Mesi, Xhevit Bushaj, Edlira Hyseni, Artur Roshi, Krenar Rryci, Ervin Bushati, Antoneta Dhima, Korab Lita, Blerina Gjylameti, Rolant Xhelilaj, Reme Lala, Eljo Hysko, Vullnet Sinaj dhe Ylli Shehu.

Mungojnë:

Suzana Topi dhe Arben Elezi.

Të ftuar

Petra Milo – Këshilltar i Presidentit për Ekonominë

Bledar Dervishaj – Këshilltar i Presidentit për Çështjet Ligjore

Katrin Treska – Drejtore e Përgjithshme e Shërbimeve Juridike

Vasilika Vjero – Zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë

Nikolla Lera - Drejtor i Përgjithshëm i Politikave Makroekonomike dhe Çështjeve Fiskale

HAPET MBPEDHJA

Anastas Angjeli – Mirëmëngjesi të gjithëve!

Përpara se të fillojmë mbledhjen, duhet të bëjmë verifikimin e kuorumit.

Arben Elezi? Mungon.

Antoneta Dhima po vjen tani nga mbledhja e Komisionit të Jashtëm.

Blerina Gjylameti? Mungon.

Ervin Bushati prezent.

Rolant Xhelilaj? Po.

Xhevit Bushaj? Po.

Reme Lalaj? Po.

Senida Mesi? Po.

Elio Hysko? Po.

Vullnet Sinaj? Nuk ka ardhur ende.

Edlira Hyseni? Po.

Krenar Rryçi? Po.

Artur Roshi? Po.

Korab Lita? Po.

Ylli Shehu? Po.

Suzana Topi? Mungon.

Të nderuar kolegë, fillojmë mbledhjen e Komisionit për Ekonominë dhe Financat. Sot në rendin e ditës kemi vetëm një çështje: shqyrtimin, në cilësinë e komisionit përgjegjës, të dekretit të Presidentit të Republikës nr. 11 912, datë 11.01.2021, “Për kthimin e ligjit nr. 151/2020 “Për një ndryshim në ligjin nr. 9975”, datë 28.07.2008, “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar”. Relator është caktuar zoti Bushati. Jua kemi vënë në dispozicion të gjitha materialet që lidhen me këtë çështje në postën elektronike.

Për të diskutuar dhe për të mbrojtur projektligjin kemi ftuar dhe janë të pranishëm: Petraq Milo, këshilltar i Presidentit për Ekonominë. Faleminderit, zoti Petraq!

Kemi zotin Bledar Dervishaj, këshilltar i Presidentit për Çështjet Ligjore. Faleminderit, Bledar!

Kemi zonjën Katrin Treska, drejtore e Përgjithshme e Shërbimeve Juridike.

Ndërsa nga Ministria e Financave janë zonja Vasilika Vjero, zëvendësministre, si dhe zoti Nikolla Lera, drejtor i Përgjithshëm i Politikave Makroekonomike dhe Çështjeve Fiskale.

Përpara se t'ua jap fjalën përfaqësuesve të Presidentit, më lejoni të theksoj se Presidenti i Republikës, bazuar në nenin 85 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ka depozituar pranë Kuvendit dekretin nr. nr. 11912, datë 11.01.2021, “Për kthimin e ligjit nr. 151/2020 “Për një ndryshim në ligjin nr. 9975”, datë 28.07.2008, “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar”. Bazuar në nenin 86 të Rregullores së Kuvendit, ky dekret është futur automatikisht në programin e punës së Kuvendit. Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e komisionit përgjegjës, bazuar në nenet 86, 32 dhe 38 të Rregullores së Kuvendit, e merr në shqyrtim këtë dekret vetëm për çështjet e paraqitura në arsyetimin për kthimin e ligjit nga Presidenti i Republikës, ndaj edhe shqyrtimi i tij do të fokusohet vetëm në këto dispozita.

E theksoj këtë për ta pasur të qartë të gjithë anëtarët e komisionit që edhe pyetjet, që çdo anëtar ka të drejtë t'i bëjë dhe diskutimet, është e domosdoshme të fokusohen brenda çështjeve mbi të cilat arsyetimi i Presidentit ka bërë kthimin e dekretit.

Fjala u jepet përfaqësuesve të Presidentit.

Kush do të flasë?

Petra Milo – Faleminderit, zoti kryetar!

Përhëndetje të gjithë anëtarëve të komisionit!

Fjalën do ta marr në radhë të parë për çështjet ekonomike dhe fiskale. Pastaj do t'ua kaloj fjalën kolegëve të mi për çështjet juridike në lidhje me dekretin e Presidentit.

Nëse më lejoni, mund të kaloj shumë shpejt në problemet që kemi paraqitur, që janë në 3 nivele: niveli politik, niveli fiskal dhe çfarë thotë eksperiencia e organizatave që janë të specializuara për këtë gjë.

Të gjitha aktivitetet qoftë industria nxjerrëse, qoftë të tjera eksportuese janë prekur nga çështja e COVID-it dhe nga ulja e prodhimit apo goditja nga çmimet e lëndëve të para. Nuk është vetëm thjesht industria e kromit apo industritë nxjerrëse që janë penalizuar nga kjo gjë.

Ka zënë vend, si të thuash, edhe vërejtja që ka bërë Fondi Monetar për ndryshimet fiskale të karakterit klientelist dhe të veçuara për një lloj industrie. Politika fiskale duhet të jetë më e gjerë, duhet të mbulojë të gjitha fushat dhe të japë incentivat për të gjitha llojet e industrive dhe jo vetëm të një industrie, siç është rasti konkret i rentës minerare.

Në relacion thuhet: “Do të shërbejë për rritjen e investimeve” dhe janë të mirëpritura, por në relacion nuk ka asgjë konkrete ndonjë perspektivë të mundshme për ndërtimin e një impianti të tillë për përpunimin e lëndës së parë që është kromi. Pra, nuk shikojmë asgjë, as në strategjinë e ministrisë përkatëse nuk ka një element të tillë dhe vjen papritur edhe nxjerrja si argument i kësaj gjëje.

Prodhimi mineral, kromi, mund të magazinohet, nuk është çështje si energjia elektrike. Në pritje të një konjuktore më të mirë të çmimeve, çështja për 1 vit nuk është një argument bindës, duke konsideruar edhe rezultatet pozitive që mund të ketë pasur kjo industri në vitet e mëparshme.

Sipas raportit të FMN-së, kjo është shumë bindëse në parashikimet e vitit 2021, pritshmëria është rritja e çmimeve të metaleve dhe të gjitha lëndëve të tjera, *commodity prices*. Kjo është e qartë. Nuk është çështje konjuktore, por e pandemisë për prishjen e linjave të furnizimit, por konjuktura për vitin 2021 është rritja e çmimeve të lëndëve, sidomos të mineraleve. Pra, nuk qëndron momenti i vazhdimësisë së uljes së çmimeve, sipas raportit prestigjioz.

Nuk është treguar në relacion një eksperiencë e ngjashme në lidhje me këtë gjë, praktikimi i uljes së rentës minerare, përkundrazi. Unë do ta shtjelloj pak më poshtë se cila është praktika më e mirë në këto raste.

E fundit, nga pikëpamja e politikës mund të bëhet mbështetja e industrisë nëpërmjet formave shumë të larmishme. Meqenëse jam këtu, po shpreh, sipas një raporti të vitit 2018, theksohet se në lidhje me industrinë minerale incentivat, që janë të zbatueshme, janë të 3 formave, kryesisht prioritare është forma e parë në lidhje me të ardhurat, duke zbatuar uljen e tatimit mbi të ardhurat, përshpejtimi i amortizimit, kreditimi ose subvencioni i interesave të kredisë, që është rasti më konkret për ndërtimin e një impianti. Qeveria mund të subvencionojë interesat bankare për investim, që është mbështetje direkte dhe më e arsyeshme, është konkrete për një rast të caktuar, sigurisht, edhe mënyra të tjera për uljen e tatimeve. Mund të operohet me mekanizmat që janë në lidhje me tarifën e importeve dhe eksporteve. Mund të operohet në lidhje me rentën minerale, por e kufizuar, siç thotë raporti që është një eksperiencë botërore, në dy raste: kur konjuktura e çmimeve është e pafavorshme, vetëm konjuktura, në fakt.

E dyta, kur burimet janë gati në përfundim. Nuk është as rasti i parë, as rasti i dytë. Kur burimi mineral është gati në përfundimin e depozitave të tij, mund të akordohet një incentivë e tillë. Nuk është rasti për çmimin, as për vitin 2021. Komisioni ka qenë më korrekt

kur e ka rakorduar këtë për një vit. Praktikisht, kjo politikë zbatohet, që është vetëm politikë e përkohshme. Më vonë ka kaluar në 3 vjet. Ka një argument më bindës komisioni sesa qeveria që jep për 3 vjet. E thotë një vit, dhe kjo faktikisht përkon me këshillat që japin institucionet ndërkombëtare, por, me diferencën që ka, përsëri qëndron argumenti që çmimet do të rriten në vitin 2021.

Nga pikëpamja fiskale është e njohur që korporatat bëjnë lobing individual. Kjo është e njohur. Kush merret me taksimin ndërkombëtar, është një nga elementet kryesore fillestare të lobingut të fuqishëm që bëjnë korporatat qoftë në pjesën e politikës, qoftë në pjesën e ekzekutivit për të fituar incentiva më të favorshme. Pikërisht ky është një rast i tillë, një rast konkret që nuk argumentohet me asnjë qoftë nga argumentet e politikës ekonomike, qoftë edhe fiskale.

Sigurisht, në vendin tonë kur mundësitë e të ardhurave janë shumë të pakta, kjo menjëherë merr rëndësi të veçantë, sidomos për pushtetin lokal.

Loyalties është një çështje sovraniteti, është një çështje e burimit që duhet të përfitojnë të gjitha komunitetet; duhet të përfitojnë prodhuesit, investitorët; duhet të përfitojë qeveria; duhet të përfitojë edhe pushteti lokal, komuniteti. Në këtë rast nuk kemi asnjë lloj përfitimi të komunitetit, përkundrazi. Po të shikojmë ligjin, shkelet edhe Kushtetuta, është një shkelje flagrante e Kushtetutës. Kushtetuta e përcakton qartë ndarjen e dy pushteteve, pushtetit lokal, që kolegu im do të flasë më tepër për këtë gjë, dhe pushtetit qendror, të cilat janë plotësisht të ndara dhe nuk kanë lidhje. Pushteti qendror nuk mund të marrë një vendimmarrje, pa e ndarë me pushtetin lokal, me faktin që edhe pushteti lokal përfiton nga taksat e rentës minerale në përqindje të caktuar. Pushteti qendror këtu do të marrë një rol më të madh që nuk i takon, duke falur diçka që nuk është vetëm e vetja, në kuptimin e politikës, por i takon edhe pushtetit lokal.

Këtu nuk bëhet fjalë për burime të rinovueshme, këto janë të parinovueshme, burimet minerale përfundojnë një ditë. Këtu qëndron edhe i gjithë thelbi i kujdesit që duhet të kenë ekzekutivi, legjislativi në mënyrë që nëse do të jepen incentiva të jenë të peshuara dhe të argumentuara dhe jo thjesht një çështje klienteliste për t'i bërë favore dikujt, një industrie, një personi e të tjera më radhë.

Sigurisht, po i rikthehem përsëri çështjes së pushtetit lokal, përderisa është pronar, në kuptimin e pronësisë së pushtetit lokal, marrja e mendimit të komunitetit dhe e njësive të vetëqeverisjes vendore është më se e rëndësishme.

Kjo cenon parimin e mbrojtjes së pasurisë kombëtare për vetë faktet që përmenda më parë. Do të kërkoja që përsëri komisioni ta shikojë me kujdes, në mënyrë që incentiva të tilla jo vetëm të mos jenë nën presionin e korporatës dhe të individëve, por edhe në disfavorin e komunitetit dhe më gjerë, në raport edhe me industrinë e tjera.

Kaq kisha nga pikëpamja e politikave dhe e politikave fiskale.

E theksoj edhe një herë se në rekomandimet që jep raporti në lidhje me incentivat nuk qëndron absolutisht asgjë në argumentet që jepen në lidhje me marrjen e kësaj iniciative.

Faleminderit!

Anastas Angjeli – Faleminderit, zoti Milo!

Fjalën e ka zoti Dervishaj.

Bledar Dervishaj – Shumë shkurtimisht: për arsye teknike, u detyruam të ishim në një zyrë, por tashme u rregulla edhe ky problem që kishim me kompjuterin.

Është për t'u evidentuar fakti se propozimi i Këshillit të Ministrave, i miratuar nga Kuvendi në seancën plenare tërësisht, është cilësuar edhe në relacionin e Presidentit, që gjatë shqyrtimit në Komisionin e Ekonomisë, komision që ka dhënë mendim për nismën ka qenë edhe Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, i cili e ka kufizuar nismën në kohë. Nisma nga 3 vjet, me përjashtim zero dhe një të tretat për periudhën në vijim, ka sugjeruar kufizimin vetëm për 2021 të këtij lehtësimi për pjesën zero për qind të taksës së rentës minerare dh pjesën e vitit 2022 me një të tretën.

Referuar raportit të komisionit përgjegjës, Komisionit për Ekonominë, është se, lidhur me këtë propozim për përjashtim vetëm për 1 vit për të dyja kategoritë, qoftë për zero për qind, qoftë me një të tretën, është mirëpritur nga qeveria, përfaqësuesi që ka marrë pjesë në shqyrtim, në fakt, kështu thotë raporti i komisioni, ku citon se për të gjithë sektorin kjo u mirëprit dhe u mbështet nga përfaqësuesi i Ministrisë së Industrisë, si dhe përfaqësuesi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Është e qartë që Komisioni për Ekonominë është organ këshillimor i seancës plenare. Ne jemi të qartë për këtë. Vendimet merren nga seanca, por është fakt se gjatë shqyrtimit në komision përfaqësues të qeverisë, të dyja komisioneve për Veprimtaritë Prodhuese dhe për Ekonominë kanë rënë dakord që propozimi fillestar i qeverisë të mos pranohej dhe t'i sugjerohej seancës një normë më e vogël lehtësimi, që do të ishte në balancë, siç tha edhe kolegu Milo, midis atyre raporteve që citojnë organizatat ndërkombëtare, të interesit publik dhe pritshmërive legjitime të subjekteve të licencuara në këtë fushë.

Kjo gjë ka ndryshuar me një amendim në momentin e fundit përmes deputetit Taulant Balla, kryetar i Grupit Parlamentar, para së të kalonte në seancë plenare.

Unë, të paktën nga salla konsultohem me faqen e Kuvendit, nuk e gjej të argumentuar kërkesën për të rikthyer variantin e parë dhe Kuvendi ka shkuar në miratimin e atij ligji që sot është objekt shqyrtimi bashkë me dekretin.

Ligji, siç e përmendi dhe zoti Milo, përbën një trajtim të favorizuar fiskal të një dege të industrisë në vetvete, qoftë edhe për sa i përket kohës. Në këtë kuadër, vlen të theksohet se situata pandemike, e cila vazhdon ende, ka sjellë efekte negative në secilën fushë të ekonomisë, në secilin subjekt, në tregun e lirë në mbarë botën.

Kësaj nisme, është vlerësuar nga Presidenti, i mungon transparencë që nga momenti që është propozuar, kur është vlerësuar apo janë analizuar kostot pozitive dhe negative në ekonomi për këtë sektor dhe për sektorët e tjerë, deri në formalizimin konkret të propozimit. Gjithsesi, është detyrë e pushtetit qendror që të thellohej në shqyrtimin e parametrave fiskalë dhe të mos krijojë situata që në dukje janë ekstreme të trajtimit preferencial, duke favorizuar degë të veçanta të industrive, të cila u nënshtrohen regjimeve të njëjta fiskale. Kjo zgjedhje vlerësohet nga Presidenti lehtësuese vetëm për një sektor dhe pa transparencë për numrin e operatorëve, për nivelin e të ardhurave vjetore që gjenerojnë, për kontributin që derdhin në buxhet dhe është tregues më tepër për një trajtim preferencial në ligj.

Shteti, thekson Presidenti në arsyetimin tij, është i detyruar të sigurojë trajtim të barabartë përpara ligjit dhe ky është një parim kushtetues, duke mos lejuar diskriminimin e subjekteve të tjera, që operojnë përmes zbatimit të dispozitave ligjore favorizuese. Nëse lind nevoja për trajtime të tilla, kjo nevojë duhet të jetë e justifikuar dhe e arsyetuar në terma konkretë, gjithmonë duke vlerësuar me shumë objektivitet, jo në kushte të tilla, me trajtime të tilla, që sjellin pasoja në pasurinë publike. Ne e citojmë pasurinë publike pasi, ashtu siç e përmendi edhe zoti Milo, taksat e rentës minerare filloi të ushtrohej ndaj atyre mineraleve, të cilat janë të shfrytëzueshme, por nuk janë të rigjenerueshme, shfrytëzohen dhe nuk rikthehen më, fjala vjen burime të tilla si uji, era apo drita. Janë pasuri të nëntokës, të cilat shfrytëzohen dhe nuk gjenerohen më.

Në momentin që faktohen të tilla politika fiskale, ligjvënësi duhet të jetë shumë i kujdesshëm, në mënyrë që interesi publik, në lidhje me atë që është e të gjithëve, nëntoka, të jetë e ruajtur përballë interesit tjetër, që të përfitojnë subjektet të cilat lehtësohen.

Një propozim i vlerësuar si pozitiv, të paktën nga ana e institucionit të Presidentit, në momentin e shqyrtimit të kësaj nisme, është propozimi i zotit Sinaj, i cili propozon edhe

rritjen në masën 25 % të të ardhurave që përfitonte pushteti vendor. Ky propozim nuk është pranuar, nuk është marrë parasysh. Ndërkohë, duke zeruar fare rentën minerare për një periudhë trevjeçare, në mënyrë indirekte Kuvendi i Shqipërisë ka cenuar atë që quhet autonomi vendore, sepse autonomia nuk mund të garantohet, nëse nuk do të ketë të ardhura të plota e të qëndrueshme. Duke mos marrë vendim edhe pushteti vendor lidhur me masën e kufizimit të këtyre të ardhurave, detyrimisht ë ka cenim të autonomisë vendore përmes ligjit.

Për të mos u zgjatur më tepër, këto janë pak a shumë arsytimi i përmbledhur i Presidentit të Republikës në dekretin e tij. Ne mund të zgjidhnim ta ta lexonim në tërësi arsyetimin prej shtatë faqesh, por në fund të ditës, arsye të përmbledhura paraqiti zoti Milo, më të përmbledhura nga ato që paraqita unë, sa i takon kontekstit juridik. Më të qarta e në mënyrë më të detajuar janë në dekretin, që të gjithë deputetët e disponojnë, kështu që për ekonominë tuaj të kohës, nuk po zgjatemi t'i lexojmë tërësisht.

Anastas Angjeli – Faleminderit, zoti Dervishaj, në lidhje me paraqitjen e dokumenteve të Presidentit!

Siç e thatë edhe ju, deputetët e kanë në dispozicion materialin e plotë. Tani, më lejoni t'ia kaloj fjalën relatorit.

Zoti Bushati, fjala për ju!

Ervin Bushati – Faleminderit!

A jam në linjë? Dëgjohem?

Anastas Angjeli – Po.

Ervin Bushati – Faleminderit!

Kemi diskutuar gjithë argumentet ekonomike dhe strukturore, të paraqitura në projektligjin e sjellë nga qeveria. Me gjithë respektin, argumentet e sjella nga Presidenca nuk kanë të bëjnë me kushtetutshmërinë, por kanë të bëjnë me argumente të kundërshtimit opozitar, në pikëpamjen që, në qoftë se do të ishin prezantimi i një opozite apo i një partie politike, mund të kishin të drejtën e diskutimit, por prapë do të rrëzoheshin në komision.

Ne i kemi dhënë edhe gjithë argumentet kushtetuese, mbi të cilat bazohemi për të propozuar projektligjin. Gjithashtu, kemi sjellë edhe efektet buxhetore, si dhe arsyetimin kryesor, për të rritur përpunimin e këtyre materialeve brenda në Shqipëri, duke rritur zinxhirin e industrisë, për të rritur më shumë punësimin, për të rritur edhe vlerën e shtuar, patjetër TVSH-në, tatim-fitimin e të gjitha, sipas logjikës së mëparshme.

Kësisoj, mendoj se qëndrojnë të njëjtat argumente që kemi kaluar, nuk shikojmë përplasje me kushtetutshmërinë, as nga pikëpamja ligjore, që do të ishte argumenti i vetëm që mund të sillte Presidenca.

Në mënyrë shoqërore, por edhe institucionale, i lutem Presidencës, që jo të gjitha projektligjet mund të vazhdojnë të kthehen kështu, sepse është humbje kohe.

Faleminderit me gjithë respektin!

Anastas Angjeli – Faleminderit, zoti Bushati!

Para se të vazhdojmë, para se të futemi në pjesën e pyetjeve e të diskutimeve, mos ka ndonjë mendim zonja Vjero dhe përfaqësuesit e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, ju lutem?

Vasilika Vjero – Jo, zoti kryetar, deri në këto momente nuk kemi komente shtesë.

Faleminderit!

Anastas Angjeli – Në rregull! Faleminderit, zonja Vjero!

Për të vazhduar mbledhjen, duke pasur parasysh faktin se duhet të jemi sa më racionalë, gjë për të cilën do të kërkoja konsensusin e të gjithëve, me qëllim që të menaxhojmë mbledhjen brenda afateve të kohës, sepse teknologjia e vënë në dispozicion është me orar të caktuar dhe do të vazhdohet me një mbledhje tjetër komisioni, do t'ju lutesha që, në zbatim të Rregullores, të procedojmë në këtë mënyrë. Nëse ka pyetje, le të drejtojmë pyetje, por pyetjet të jenë pa komente. Do t'ju lutesha shumë: pyetje dhe vetëm pyetje. Në qoftë se keni komente, mund ta merrni fjalën përsëri për diskutim, por jo një herë pyetje me diskutim, e pastaj diskutim me pyetje. Kështu nuk funksionon dot as Rregullorja e as komisioni.

Korab, fjala për ju! Pyetje.

Korab Lita – I kam bashkë, pyetje e diskutim.

Anastas Angjeli – I ke bashkë?

Korab Lita – Po pra. Do të flas një herë, nuk do të flas dy herë.

Anastas Angjeli – Në rregull! Je i mirëpritur.

Korab Lita – Dakord, zoti kryetar!

Projekti i ardhur nga Kryeministria, nga Kryeministri, në lidhje me ndryshimin në taksën për rentën minerare, ashtu siç e dimë të gjithë dhe siç e thanë edhe parafolësit, është diskutuar në Komisionin e Ekonomisë, është ndryshuar nga varianti fillestar me dakordësinë e përfaqësuesve të Ministrisë së Industrisë, përfaqësuesit e Tatimeve, përfaqësuesit e qeverisë, që kanë qenë në mbledhjen e Komisionit të Ekonomisë, me propozim nga zoti

Beqaj, i cili e bëri propozimin nga Komisioni i Veprimtarive Prodhuese, u vendos dhe u pa e arsyeshme që taksa të hiqej për një vit edhe për industrinë prodhuese, edhe për atë përpunuese.

Sigurisht, argumentet e paraqitura nga zoti Bushati nuk qëndrojnë, pasi zoti Bushati po bën politikë në lidhje me këtë. Nëse ai thotë se janë një mijë e sa punonjës të punësuar në këtë industri, unë po i them se janë dhjetëfish punonjësit që ndodhen në industrinë nxjerrëse të mineralit. Kësisoj, në këtë këndvështrim, është shumë më e ndershme të themi se projekti fillestar i propozuar nga Kryeministria është një projekt klientelist, i cili ka dhe një emër: synon që gjithë industrinë prodhuese të mineralit ta çojë në një derë të caktuar në industrinë përpunuese, që e ka emrin Zamir Mane. Kjo ishte qoka e radhës, që Kryeministri donte t'i bënte njërit prej oligarkëve shqiptarë. Kjo është e padiskutueshme.

Mua më vjen shumë keq që varianti i miratuar në Komisionin e Ekonomisë, si komision parlamentar, u ndryshua në momentet e fundit, në mënyrë krejt të kundërligjshme nga ana e Kryetarit të grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, pasi edhe kjo mënyrë ndryshimi ka një procedurë të caktuar në seancë, e cila nuk është ndjekur. Pra, në njëfarë mënyre, komisioni është anashkaluar fare. Projekti i dalë nga Komisioni i Ekonomisë dhe Komisioni i Veprimtarive Prodhuese u ndryshua në mënyrë arbitrare. Deputetëve iu paraqit për votim një projekt, i cili nuk kishte kaluar në Komisionin e Ekonomisë dhe në Komisionin e Veprimtarive Prodhuese.

Pra, në këtë këndvështrim, pa hyrë në pjesën ligjore, të cilën e argumentojnë më së miri arsyet e kthimit, në dekretin e Presidentit, të cilin me këtë rast e përshëndes për kthimin që i ka bërë kësaj qoke të radhës së qeverisë për një oligark. Unë e kam votuar variantin e miratuar në Komisionin e Ekonomisë, meqenëse i prekte të gjithë dhe, në njëfarë mënyre, lehtësonte plagën që pandemia kishte shkaktuar mbi gjithë industrinë minerare. Unë e kam votuar pro, por në këto kushte, nëse nuk kthehem te varianti, i cili saktëson qartë se për një vit përjashtohet e gjitha industria minerare, e pastaj vjen në mënyrë të shkallëzuar, do ta votoj kundër këtë variant. Unë do ta tërheq votën, do ta votoj kundër këtij varianti, të cilin ju po mundoheni ta bëni, që ta çoni deri në fund qokën që keni projektuar t'i bëni dhuratë një oligarku, dhe do ta votoj pro dekretin e Presidentit.

Faleminderit!

Anastas Angjeli – Faleminderit, zoti Korab!

Tani duhet të kemi parasysh dy gjëra, nisur nga diskutimi i zotit Korab: duhet të jemi të kujdesshëm në nominimin e personave që kanë biznese të caktuara. Nuk është as e drejta e

komisionit e as e kurrkujt, që t'i nominojë dhe të aludojë për persona të caktuar, të cilët kanë një veprimtari të tyre. Po të keni gjëra konkrete se bëjnë gjëra të paligjshme, drejtojuni atyre që merren me këtë punë. Me sa kam dijani, janë rreth njëzet biznese që merren me çështjet që kanë të bëjnë me këtë projektligj.

Së dyti, është e drejta...

(Ndërhyrje nga ana e zotit Lita)

Më fal, të mbaroj!

Është e drejta e çdo deputeti në seancë plenare, duke zbatuar Rregulloren e Kuvendit, që njëzet e katër orë përpara të paraqesë amendament. Në qoftë se ka paraqitur amendament kryetari i grupit parlamentar, e ka paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit. Në qoftë se ai amendament ka marrë mbështetje në Kuvend, ai është shndërruar në vendim, i cili i është përcjellë me projektligjin Presidentit të Republikës.

Faleminderit!

Fjalën e ka Edlira, zonja Edlira.

Korab Lita – Zoti kryetar!

Anastas Angjeli – Po.

Korab Lita – Nxorëm disa argumente. Unë po jua them prapë. Nëse ju keni frikë që e dëgjuat atë fjalë, ky është problemi juaj. Unë nuk kam frikë ta them.

Anastas Angjeli – Tërë këtë periudhë s'e ke kuptuar këtë gjë ti? Unë zbatoj ligjin dhe Rregulloren. Ti shko në gjykatë dhe ankohu për këdo që të duash. Unë po them se janë njëzet biznese, të cilat merren me aktivitete në fushën përkatëse.

Korab Lita – I vetmi biznes përpunues është biznesi i Zamir Manes, ndërsa të tjerët janë satelitë.

Anastas Angjeli – Merru ti me atë punë!

Korab Lita – Industria nxjerrëse e mineraleve është dhjetëfish më e rëndësishme se ajo e një personi. Kjo është një dhuratë që i bëhet Zamir Manes, për të gllabëruar të gjithë prodhimin e nxjerrë me shumë mund e sakrificë, duke i zhytur në borxhe bizneset prodhuese, për t'ia dorëzuar gjithë mineralin...

Anastas Angjeli – Ke të drejtë, por këtu përpara kam të zbardhur diskutimin në mbledhjen e kaluar: nuk e ke pasur këtë mendim dhe nuk i ke thënë këto gjëra.

Fjala për zonjën Edlira.

Korab Lita – ...U vendos që të përfshihej në heqjen e taksës për një vit e gjithë industria minerare.

Anastas Angjeli – Po nuk e ndryshon emrin e biznesit fakti që është ndryshuar nga 1 në 3, kështu që po deshe, e lëmë këtë diskutim. Ti i the mendimet e tua, e shprehe votën tënde.

Fjala për Edlirën.

Korab Lita – ...që të hiqet për një vit për të gjithë industrinë përpunuese, dhe pas një viti...

Anastas Angjeli – Fjala për Edlirën, të lutem!

Edlira Hyseni – Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje!

Anastas Angjeli – Më fal, ke pyetje, diskutim apo të dyja bashkë? I kam bashkë, njëherësh, se nuk arrij t'i ndaj.

Anastas Angjeli – Jemi në rregull!

Edlira Hyseni – Dëgjohem? Mund të flas?

Anastas Angjeli – Po, po.

Edlira Hyseni – Në rregull! Atëherë, është një ligj që, në fakt, jemi të ndërgjegjshëm – unë fola edhe në parlament herën e kaluar, kur ky ligj kaloi – lidhur me paqartësinë e ligjit që ne miratuam. Na del një problem i madh në lidhje me çfarë ne vetë jemi të bindur se kemi kaluar, çfarë do të zbatohet, dhe si është praktika.

Unë e lexova dekretin, por s'e rilexova dot sot, sepse s'pata drita, por ndoqa argumentimin që i bënë përfaqësuesit e Presidencës. Unë do të doja të ndanim dy gjëra. Ajo që mund të ketë prekur ose që mund të jetë e drejtë në argumentimin që bën dekreti, është barazia para ligjit. Pra, a kemi një trajtim preferencial të njëjës degë përkundrejt të tjerave?

Unë mendoj se biem të gjithë dakord se është një vit i vështirë, sepse pa dyshim, pandemia e ka prekur sektorin minerar si të gjithë sektorët e tjerë të ekonomisë, kanë rënë çmimet në bursa, ka problematika të mëdha lidhur me industrinë minerare, qoftë atë nxjerrëse-prodhuese me qëllim tregtimin direkt, qoftë atë përpunuese.

Personalisht, nuk e paragjykoj faktin se dëshirohet apo se ka një objektiv për të ndihmuar industrinë përpunuese, sepse sipas shifrave që na dha herën e kaluar zoti Lera, në mos gabo, bëhet fjalë për rreth tre mijë e gjashtëqind të punësuar në industrinë përpunuese, por janë po aq, në mos më shumë, të paktën rreth katër mijë e pesëqind, me sa i kam mbajtur shënim shifrat, në industrinë minerare nxjerrëse-prodhuese, që pastaj i përdor për synime të ndryshme mineralet që nxjerr.

Pra, nëse në këtë vit pandemie do të ndihmojmë industrinë minerare, kemi detyrimin të ndihmojmë dhe të jemi të barabartë në trajtimin e të gjithë operatorëve në këtë lloj tregu.

Ligji që ne miratuam, që sot Presidenti e kthen, zeron taksën, rentën vetëm për industrinë përpunuese. Në fakt, flasim sepse u dha edhe në medie, e në lajme u bë më e qartë: 9% apo 10 % bëhet 0 % ; 3 % apo 4 % bëhet 0%.

Po kujt i bëhet 0%? Në fakt, doja të korigjvoja zotin Dervishaj, që më përpara tha se zerimi rentës heq të ardhurat vendore. Në fakt ulen, por nuk zerohen, sepse renta nuk bëhet zero për të gjithë, por bëhet zero për një fashë. Pra, atyre që nxjerrin, që prodhojnë dhe e çojnë lëndën te përpunuesi, u bëhet ky lehtësim fiskal, u bëhet zero, dhe këtu flasim për 9 % në blerje. Në mos gabohem, aktualisht është 9 % në blerje dhe 3 % në shitje. Pak a shumë funksionon si TVSH-ja. Këtyre u bëhet zero, ndërsa të gjithë të tjerët, që do të nxjerrin minerale dhe do t'i tregtojnë, do t'i eksportojnë direkt, pa i kaluar për përpunim, atyre u mbetet 9 %.

Problemi është këtu, domethënë: çfarë po ndihmojmë ne? Çfarë po bëjmë? Ideja e Komisionit të Ekonomisë herën e kaluar, që të bëhej një vit, ishte për efektet financiare negative që sjell në buxhet ky ndryshim.

Zoti Lera na tha se edhe raporti, në fakt edhe relacioni që shoqëron ligjin, me këtë ndryshim që bëhet sot, flasin për 500 milionë lekë të reja, për tre vite, efekt financiar negativ.

Ajo që ne kërkuam është që, nëse ua bëjmë vetëm këtyre, dhe kemi 500 milionë, po nëse e shtrijmë këtë lehtësim fiskal edhe më gjerë, sa do të ishte efekti negativ në buxhet? Dhe ishte mjaft i lartë. Nuk mund të konsiderohej për tre vite, ndaj u mendua të bëhej për një vit.

Tani, jemi të ndërgjegjshëm se 0 % edhe për prodhimi, tregtim, eksport direkt, edhe për përpunim, do të ishte një impakt negativ mjaft i konsiderueshëm, mendoj dhe i papërballueshëm për buxhetin tonë, por mund të konsiderohej një ulje e reduktuar prej 3 %, po themi, për të gjithë.

Pra, nëse do të lehtësojmë industrinë përpunuese me këtë barrë fiskale, duke e ulur atë në 0 %, atëherë edhe ata që nxjerrin dhe prodhojnë për efekt eksporti, pa e kaluar për përpunim, të ndihmohen duke e ulur rentën në një shkallë të reduktuar me 2 %, 3 %, 4 %. Pra, të ndihmohet edhe ai sektor, ashtu sikundër po ndihmohet industria përpunuese.

Unë personalisht, edhe herën e kaluar kam mbrojtur ndryshimin ose ndihmën që po i bëhet sektorit mineral, por do të doja që ajo të shtrihej për të gjithë operatorët. Pra të gjitha ato biznese, të cilat sot nxjerrin, prodhojnë dhe eksportojnë direkt minerale, por edhe ato që e

çojnë për përpunim, të kenë një ndihmë për kushtet ku jemi. Meqenëse efekti financiar është mjaft i lartë, mos të jetë në tre vjet, por të jetë i shtrirë një vit për të gjithë.

Në fakt, unë e kam mbështetur dhe vazhdoj ta mbështes edhe idenë, propozimin e zotit Sinaj, por 25 % më duket e lartë. Nga 5 % e të ardhurave nga renta, që është sot për bashkitë, për pushtetin vendor, të shkojë në 25 %, mendoj se nuk do të pranohej, sepse buxheti do ta ndjente fort efektin, por një rritje edhe në përqindjen që pushteti vendor, pra bashkitë që i kanë këto burime natyrore dhe janë të privileguara, që të kenë mundësinë të zhvillohen më mirë, është e drejtë të përfitojnë më shumë. Pra, një rritje do të ishte e pranueshme.

Meqenëse ky ligj u rikthye nga Presidenti me argumentimin e parimeve kushtetuese që janë prekur, që janë diskutuar aty, duke qenë që vetë ligji midis komisionit dhe parlamentit pati një paqartësi se çfarë thamë, çfarë votuam dhe çfarë u miratua në fund, unë do të doja që, nëse komisioni e ka dëshirën dhe vullnetin ta rishikojë, të bëjë një përmirësim. Nëse na thotë edhe Ministria e Financave, nëse ka ndonjë ide se sa do të ishte efekti financiar, nëse do të bënim një ulje, ta themi, 3% për të gjithë dhe të jetë për një vit, jo për 3 vjet. A arrijmë diku te 500-milionëshi, që është sot efekti aktual, apo është shumë më i madh, apo më i papranueshëm? Do të doja të dija nëse Ministria e Financave ka një ide se sa do të ishte ndikimi.

Unë mendoj që të punësuarit, që janë mbi 8 mijë në të gjithë industrinë minerare, edhe atë që është për eksport direkt, edhe atë që është për efekt përpunimi, kanë nevojë të ndihmohen në këtë vit të vështirë. Prandaj, nëse do të ndihmojmë industrinë përpunuese, dhe unë s'kam asgjë me biznesmenët që kanë fabrikat e përpunimit dhe na japin punësim, na japin të ardhura, nuk paragjykoj askënd, por nëse do të ndihmojmë ata, le të ndihmojmë me të njëjtën normë, me të njëjtën zbritje, edhe ata të tjerët për të qenë të barabartë përpara ligjit dhe për një ekonomi tregu më mirfunksionale.

Kështu që, unë do ta mbështes dekretin, sepse jam për rishikim të këtij ligji që shpresoj të përmirësohet dhe të bëhet më i mirë.

Faleminderit!

Anastas Angjeli - Faleminderit!

Urdhëroni, zonja Vjero!

Vasilika Vjero – Zoti Angjeli,

Ne vijojmë t'i përmbahemi të njëjtit qëndrim me draftin që kemi prezantuar dhe diskutuar edhe pranë jush për përjashtimin apo për zerimin për 3 vjet të kësaj takse për

kategorinë e prezantuar në këtë projektligj, pasi gjykojmë, edhe në relacion janë prezantuar qartë të gjitha arsyet, duke filluar që nga pandemia, vështirësitë me të cilat po përballet ky sektor, duke renditur më tej edhe kërkesën që ka ardhur nga shoqata e prodhuesve, kërkesën dhe miratimin që ka ardhur nga Ministria e Energjetikës dhe Infrastrukturës, njëkohësisht Këshilli Konsultativ, i cili është një organ i pushtetit vendor ku është diskutuar gjerësisht dhe ka shprehur miratimin për këtë projektligj që është prezantuar për një periudhë trevjeçare vetëm për atë kategori biznesesh, të cilët pas nxjerrjes së mineralit e përpunojnë atë, i shtojnë vlerë të shtuar dhe më tej e eksportojnë.

Zerimi i taksës për një periudhë trevjeçare me një efekt 3 vjet, të munguara në buxhet, janë 500 milionë lekë. Ne nuk kemi sot shifra për të bërë edhe një kalkulim të asaj se çfarë prezanton zonja Hyseni, por vijojmë t'i përmbahemi prezantimit që është bërë nga ana jonë.

Anastas Angjeli – Faleminderit, zonja Vjero!

Për diskutimin e zonjës Edlira kisha vetëm një koment të vogël, se po e dëgjoja dy herë edhe nga argumentet, që pushteti vendor cenohet nga pikëpamja financiare. Në fakt, po të bësh llogaritjet, është një shumë minimale, shumë e vogël, që nuk besoj se është kjo principalja në gjithë këtë diskutim që po bëjmë. Po të vesh në raport shumën që përmendët ju, 500, me 59,6 sa është shuma tjetër, nuk i bie as 4-5%, sidoqoftë ju e thatë, por sa për ta ditur opinionin publik, sa për ta ditur edhe ju.

Urdhëroni, zoti Roshi!

Artur Roshi – Faleminderit, kryetar!

Unë do t'i bie shkurt, se i bie të përsëris veten. Qëndrimi im ka qenë kundër qysh herën tjetër. Sigurisht, në parim jam për uljen e taksave të biznesit, por në parim, jo në rastin konkret që është selektiv vetëm për një kategori të caktuar, industrinë përpunuese në rastin konkret. Kështu që unë do të jem pro dekretit të Presidentit. Nuk kam ndryshuar asgjë në qëndrimin tim. Sërish do t'i qëndroj mendimit, kur kam mbështetur amendamentin e zotit Sinaj.

Gjithë Komisioni i Ekonomisë, kur shkuam në Selenicë, u premtuam se do të mbanim një qëndrim të tillë, edhe, thjesht, për çështje të karakterit, unë po e mbështes, madje u kemi thënë jo 25%, por edhe më shumë se 25%.

Për sa i përket asaj që Presidenti është kthyer në një pjesë të opozitës apo në një partner të opozitës, kjo më duket anatemim i anëtarëve të komisionit, sepse ne duhet të dimë që ligji (le të përmendim thënien e Aristotelit që “Ligji është bazë e arsyes dhe

informacionit”), pastaj ku e shkel Kushtetutën, ku i qëndron Kushtetutës, këto janë gjëra interpretuese dhe nuk kanë bazamentin e logjikës dhe të arsyes.

Kështu që Presidenti ishte në të drejtën e vet për ta kthyer, ne jemi në të drejtën tonë për të dhënë mendimet, për ta votuar pro ose kundër dhe këtu mbaron historia.

Për ta mbyllur, do të thosha që ata oligarkët pa emra këtu duken, te vendosja selektive e taksave. Emrat nuk e kam për zakon t’i them, por duket që prapa ka edhe interesa dhe oligarkët janë prezentë, një dorë e kanë te qeveria, një dorë e kanë te biznesi i tyre, për atë që Kryeministri hodhi poshtë sot, në deklaratën që bëri nga Korça, kur tha se nuk ekzistojnë oligarkët. Oligarkët ekzistojnë, por në një formë tjetër, siç eksitojnë koncesionet në forma të tjera, pra Lindja adopton, merr emërtesën nga Perëndimi dhe bën adoptimin ala Lindje. Kjo është e gjitha.

Kështu që vota ime do të jetë pro dekretit të Presidentit. Ftoj çdokënd që ka një lloj logjike, përtej pasioneve politike ta votojë pro këtë projektligj.

Faleminderit!

Anastas Angjeli - Faleminderit!

Urdhëroni, zonja Dhima!

Antoneta Dhima – Faleminderit, zoti kryetar!

(Nuk dëgjohet)... miratuar këtë projektligj në cilësinë e komisionit përgjegjës. Njëkohësisht, edhe në seancë plenare ky projektligj është miratuar me shumicë të anëtarëve të pranishëm në seancë plenare. Sot ne po diskutojmë dekretin, pasi Presidenti e ka kthyer këtë projektligj me argumente, të cilat përfaqësuesi i Presidencës i tha, por njëkohësisht zonja Vjero dhe zoti Bushati, në cilësinë e relatorit, thanë argumentet për miratimin e këtij projektligji, të cilin ne si komision po e rishqyrtojmë në kushtet e kthimit nga ana e Presidentit.

Unë mendoj që argumentet janë të mjaftueshme që ne si komision të vazhdojmë me miratimin dhe unë jam kundër dekretit të Presidentit dhe do t’i ftoja të gjithë kolegët që të votojnë kundër këtij dekreti.

Faleminderit!

Anastas Angjeli - Faleminderit!

Zoti Dervishaj.

Bledar Dervishaj – Për të saktësuar, se shpesh gjatë diskutimeve, qoftë në Komisionin e Ekonomisë, të Medies apo edhe të Komisionit të Ligjeve, ka qasje politike të deputetëve apo edhe të relatorëve të projektligjeve që Presidenti kthen shumë ligje apo

Presidenti e kthen ligjin, apo kapërcen Kushtetutën, unë dua ta sqaroj një herë e mirë që roli i Presidentit në procesin legjislativ është kushtetues dhe është i shprehur në dy dispozita kushtetuese.

Neni 85, pika 1, “Presidenti ka të drejtë ta kthejë ligjin vetëm një herë, duke e shoqëruan me arsytet konkrete”.

Arsyet e kthimit të ligjit janë të natyrës kushtetuese dhe të ruajtjes së interesit publik, janë të asaj natyre që përse merr nisma shkas, ku propozohet nga Këshilli i Ministrave, me të njëjtin motiv edhe Presidenti ka arsytet e veta që e kthen. Asnjëherë këto arsye, të paktën, për sa njohim nga historia nga '98-ta e deri tani, nuk kanë qenë arsytetime politike po kanë qenë arsytetime referuar parimeve themelore, ruajtjes së të drejtave themelore kushtetuese apo të drejtave sociale shoqërore, apo vlerësimit se si Presidenti i ka bërë një normë që mund të ishte dhe do të mbronte më mirë interesin publik.

Përveç kthimit si një e drejtë kushtetuese, Presidenti, në procesin legjislativ i përcjell edhe mesazhe Kuvendit (e ka të shprehur në nenin 92) dhe mesazhe më të qarta dhe më të pastra se ç'mund t'i shprehë përmes dekretit dhe arsyeve të tij nuk ka. Është moment deciziv për t'i thënë Kuvendit “kujdes, keni një llampë të kuqe ndezur, në nivel kushtetues, në nivel të interesit publik duhen rivlerësuar.

Ne e thamë edhe pak më parë se kanë rëndësi parimet dhe jo masat. Është e vërtetë që 5% apo 25% të pushtetit vendor, sa më shumë aq më mirë, por nuk do të thotë që u lehtësohet 5% dhe nuk është ndonjë ndikim i madh, ndërkohë që parimi i ndërhyrjes në decentralizim apo në autonomi është realizuar. Këtu kemi kërkuar kujdes të veçantë.

Të them të drejtën, në vlerësimin që i keni bërë normës, veprimtaria e Komisionit të Ekonomisë është gjetur deri diku objektive për shkak të ndryshimit të propozimit të qeverisë. Është qeveria e cila ndryshon mendim herë pas here, qoftë gjatë momentin kur diskutohet në komisionin tuaj, ku biehet dakord me komisionin që të ulet nga 3 në një 1 vit apo pjesa tjetër me 1/3 pa afat, ndërkohë që e çon në limit, ndërkohë që sërish bie dakord prapë me propozimin e një deputeti, që ka të drejtën e tij kushtetuese patjetër, por është qeveria që sërish mbështet qëndrimin që para 4 ditësh e kishte pasur ndryshe.

Ne kërkojmë pranimin e dekretit.

Anastas Angjeli – Faleminderit, zoti Dervishaj!

Së pari, unë nuk besoj se ka vend në këtë diskutim për të diskutuar dhe për të hedhur dyshime nëse ka të drejtë Presidenti i Republikës apo nuk ka, për të kthyer aktet ligjore dhe asnjë nga deputetët nuk mundi të shprehej për këtë çështje dhe as aludoi për këtë çështje.

Presidenti i Republikës është në të drejtën e vet kushtetuese. Nuk është hera e parë, është e disata dhe mund të jetë edhe akoma e disata herë. Në këtë kuptim nuk besoj se ka vend për debat që të diskutojmë nëse ka të drejtë Presidenti apo jo, prandaj mos i jepni kaq shumë vëmendje dhe kohë një çështjeje që nuk ekziston dhe që nuk u diskutua këtu në komision nga asnjë nga deputetët.

Në qoftë se doni t'i jepni më tepër vëmendje, është e drejta e juaj, siç edhe e drejta e të gjithë deputetëve. Ashtu siç është e drejtë kushtetuese e Presidentit për të kthyer një akt ligjor, një herë dhe vetëm një herë, ashtu është edhe e drejta e deputetëve në komision dhe në parlament për ta diskutuar dhe ta votuar atë. Kështu që, nga kjo pikëpamje pozitat janë të barabarta.

Natyrisht, në qoftë se ndonjë nga deputetët e tejkalon kufirin e diskutimit nëpërmjet politizimit të tejskajshëm të çështjes, duhet parë nga të dyja anët se kush dhe sa e politizon çështjen.

Së treti, sa i përket autonomisë vendore. Flasim për autonomi vendore apo flasim për autonomi financiare vendore? T'i ndajmë këto dy gjëra. Në qoftë se me një projekt preket 1% e të ardhurave edhe më një projekt tjetër shtohet 5% e të ardhurave, nuk kemi ndonjë cenim primar të autonomisë vendore, që t'i ndajmë autonomimë vendore nga autonomia financiare, si pjesë e autonomisë vendore.

Urdhëroni, zoti Lita!

Korab Lita – Faleminderit, kryetar!

E ndoqa me vëmendje diskutimin tuaj dhe të kolegëve deputetë, por, në fakt, unë doja t'i bëja një pyetje përfaqësuesve të Ministrisë së Financave.

Çfarë do të ndryshonte në buxhet miratimi i këtij projektligji dhe efektet financiare që do të sillte në dëm të ekonomisë?

Mendoj se sot në treg duhet të jemi të barabartë në raport me ligjin, pra duhet të trajtohem njësoj para ligjit, jo një pjesë që mendojmë se janë “oligarkë” të pashpallur, se oligarkët nuk shpallen ata punojnë gjithmonë nën rrogë, në heshtje, por do të thosha se edhe pjesa tjetër e ekonomisë do mbështetje të fuqishme, prandaj besoj dhe mendoj se në treg duhet të jemi të barabartë.

Anastas Angjeli – Urdhëroni, zonja Vjero!

Vasilika Vjero – Unë theksoj edhe një herë që ky projektligj parashikon heqjen e rentës minerare për një periudhë 3-vjeçare për grupin e mineraleve metalore, të cilat përpunohen në vend. Pra, të gjitha ato kompani të cilat janë 5, 6 apo edhe më shumë që

prodhojnë dhe ndërkohë edhe e përpunojnë mineralin e tyre e më tej e çojnë për eksportim duke ia rritur vlerat, do të jenë këto kompani, të cilat do të përftojnë edhe nga ky përjashtim për 3 vjet.

Efekti financiar që kemi parashikuar dhe prezantuar edhe në këtë projektligj është në masën 500 milionë lekë, pra do të jetë një minus në buxhetin qendror për periudhën 3-vjeçare.

Anastas Angjeli – Faleminderit, zonja Vjero!

Faleminderit të gjithë pjesëmarrësve, të ftuarve, zotit Bledar, zotit Petraq që ishit sot me ne në diskutimin e dekretit të Presidentit të Republikës dhe për argumentet dhe mendimet që dhatë!

Faleminderit, deputetëve që diskutuan!

Kalojmë në procesin e votimit.

Për dekretin e Presidentit të Republikës votohet vetëm një herë dhe komisioni vendos rrëzimin e dekretit apo pranimin e tij.

Kush është dakord me dekretin e Presidentit të Republikës?

4 vota pro dekretit të Presidentit të Republikës.

Kush është kundër dekretit të Presidentit të Republikës?

7 vota janë kundër dekretit të Presidentit të Republikës.

Abstenim? Nuk ka.

Me 7 vota kundër dhe 4 pro rrëzohet dekreti i Presidentit të Republikës.

Faleminderit shumë!

Mirë u takofshim ditën e enjte, sipas njoftimit që do t'u bëhet në postën elektronike për rendin e ditës.

Mirupafshim!

MBYLLET MBLEDHJA

Sekretar

Anastas Angjeli

Përgjegjësja e Sektorit të Redaktorëve

Euzheni Pengili

**Sekretar i komisionit
Elvi Prifti**